



VENDIM MBI PAPRANUESHMËRI

Data e miratimit: 17 tetor 2017

Numri i lëndës: 2017-03

Alfred Bobaj

kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 17 tetor 2017, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese
Z. Guénaél METTRAUX, anëtar
Znj. Elka ERMENKOVA, anëtare

Ndihmuar nga
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe Rregullores së Punës së Panelit siç është ndryshuar së fundi me 15 janar 2013,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

I. PROCEDURAT PRANË PANELIT PËR SHQYRTIMIN E TË DREJTAVE TË NJERIUT

1. Ankesa është regjistruar në Panel me datën 10maj 2017.

II. FAKTET E LËNDËS

2. Faktet e lëndës të paraqitura nga ankuesi mund të përmbliidhen si më poshtë:

3. Ankuesi, së bashku me avokatin e tij *ex-officio*, ka negociuar lidhur me një marrëveshje për pranimin e fajësisë me një prokuror të Kosovës. Marrëveshja, siç e kuptonte ai në atë kohë, ishte se ai do të dënohej me pesëmbëdhjetë (15) vjet burgim. Supozohet se atij nuk i ishte thënë se me nënshkrimin e marrëveshjes ai do të hiqte dorë nga e drejta e tij për të apeluar. As avokati i tij duket se nuk ishte në dijeni për këtë fakt.
4. Me 5 janar 2016, Gjykata Themelore, Prizren, Departamenti i Krimeve të Rënda, ka dënuar ankuesin me shtatëmbëdhjetë (17) vjet burgim.
5. Ankuesi ka apeluar ndaj këtij aktgjykimi dhe me 15 mars 2016 Gjykata e Apelit ka shpallur këtë ankesë të papranueshme.
6. Me shkresën e datës 31 tetor 2016, ankuesi ka kërkuar që çështja të shqyrtohej nga Gjykata Supreme e Kosovës.
7. Me 30 janar 2017, Gjykata Supreme e ka refuzuar si të pabazuar kërkesën e ankuesit dhe ka vërtetuar aktgjykimin e Gjykatës Themelore të Prizrenit. Në asnjë fazë të procedurave gjyqësore EULEX-i nuk ishte i përfshirë në shqyrtimin e kësaj lënde.
8. Me një letër të datës 24 shkurtit 2017 drejtuar kryetarit të Gjykatës Themelore të Prizrenit, ankuesi ka shprehur shqetësimet e tij lidhur me parregullsitë e pretenduara në procedurat pranë kësaj gjykate.
9. Me 13 mars 2017, kryetari i Gjykatës Themelore, Prizren, iu ishte përgjigjur letrës dhe ka informuar ankuesin se parregullsitë e pretenduara në caktimin e dënimit kanë rënë jashtë juridiksionit të tij. Kryetari gjithashtu ka informuar ankuesin se mund të shfrytëzonte mjetet juridike të parapara në Kodin e Procedurës Penale të Kosovës.
10. Ankuesi më tej ka pohuar se kishte paraqitur një ankesë në EULEX për të kërkuar që të ndërrohej prokurori, përkatësisht që një prokuror i EULEX-it të merrte përsipër lëndën.

III. ANKESAT

11. Ankuesi ka pohuar se kishte një problem personal të një natyre të pasaktësuar me prokurorin e Kosovës dhe se kjo kishte pasur një efekt negativ në rezultatin e lëndës. Ai më tej është ankuar, pa u thirrur në ndonjë dispozitë të veçantë të instrumenteve ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, lidhur me rezultatin dhe veprimin e lëndës së tij. Mund të supozohet se ankuesi pretendon shkelje të neneve të mëposhtme: Neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut ("Konventa")/neni 14 i Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike ("KNDCP") (gjykim i drejtë) dhe neni 13 i KEDNj-së/neni 2(3)(a) KNDCP (mohimi i mjeteve juridike).

IV. LIGJI

12. Si çështje e së drejtës materiale, Paneli është i autorizuar që të zbatoj instrumentet e të drejtave të njeriut siç pasqyrohen në Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 mbi themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut. Me rëndësi të veçantë për punën e Panelit janë Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, të cilat përcaktojnë standardet minimale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut që duhet të garantohen nga autoritetet publike në të gjitha sistemet ligjore demokratike.
13. Para shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës, Paneli duhet të vendosë nëse do t'i pranoj ankesat, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me rregullën 29 të rregullores së punës.
14. Sipas rregullës 25, paragrafi 1, Paneli mund të shqyrtoj vetëm ato ankesa që kanë të bëjnë me shkeljet e të drejtave të njeriut nga EULEX-i Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv në gjyqësi, polici dhe dogana.
15. Paneli thekson që ankesa e ankuesit në thelb ka të bëjë me një ankesë lidhur me ashpërsinë e dënimit që ai kishte marrë në shkallën e parë dhe e cila më pas ishte vërtetuar.
16. Paneli konstaton se në bazë të rregullës 25, paragrafit 1, bazuar në konceptin e llogaridhënies në OPLAN-it të EULEX-it Kosovë, në parim Paneli nuk mund të shqyrtoj procedurat gjyqësore të gjykatave të Kosovës. Paneli nuk ka kompetencë as në fushën administrative e as në fushën juridike të punës së gjykatave të Kosovës.
17. Për më tepër, në bazë të dokumenteve të paraqitura në Panel, nuk është treguar se prokurorët e EULEX-it kanë luajtur ndonjë rol në shqyrtimin e lëndës së ankuesit.
18. Prandaj çështja rreth së cilës është ankuar ankuesi bie jashtë kompetencave të Panelit, siç është saktësuar në rregullën 25 të rregullores së punës (*Shaip Gashi kundër EULEX-it*, 2013-20, 26 nëntor 2013, paragrafi 9, *Jovanka, Dragan dhe Milano Vuković kundër EULEX-it*, nr. 2013-18, 7 prill 2014, par. 11-12).

PËR KËTO ARSYE,

Paneli njëzëri konstaton se nuk ka kompetencë për ta shqyrtuar këtë ankesë në bazë të nenit 29 (d) të rregullores së vet të punës, dhe prandaj

SHPALL ANKESËN TË PAPRANUESHME.

Për Panelin,

John J. RYAN
Zyrtar i lartë ligjor

Magda MIERZEWSKA
Kryesuese